



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Më: 27 mars 2026

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 27 mars 2026 (e premte) në sallën e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në ora 10:00 minuta.

Pjesëmarrës nga KPF-ja, ishin: Simir Krasniqi, Kryesues i KPF-së, Ymran Fusha, Trëndelina Kastrati, Arianit Berisha, Dafina Alishani, Ilir Gashi, Haziz Hodaj, Agnesa Sinanaj Gavazaj dhe Shukri Quni, të gjithë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pjesëmarrës tjerë ishin: Bexhat Bytyqi – Drejtor i Administratës, Florent Ukaj – Drejtor i Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinor, Fatmir Memaj – Drejtor i Mirëqenies Sociale, Fejsal Hoti – Zyrtar nga drejtoria e shërbimeve publike, Idaim Kryeziu – Zyrtar nga drejtoria e emergjencave, Arbër Krasniqi – Zyrtar nga zyra e Kuvendit të Komunës, shoqëria civile dhe mediat lokale.

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë fillojmë, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politik dhe financa, të nderuar përfaqësues të mediave, drejtorë të ekzekutivit, zyrtarë komunalë, përfaqësues nga OSBE-ja, të nderuar të pranishëm, sot po e mbajmë mbledhjen e tretë për vitin 2026 të Komitetit për politikë dhe financa, ku të pranishëm janë nëntë anëtarë të KPF-së, pra të komitetit. për politikë dhe financa, meqënëse kemi korum të mjaftueshëm, po e fillojmë me këtë mbledhje, materialin dhe ftesën për mbledhje ju kemi shpërndarë me kohë sipas afateve ligjore, për punën e kësaj mbledhje të Komitetit për politikë dhe financa do të jetë ky rend dite:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së rregulltë të KPF-së, të datës 25 shkurt 2026;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin dhe përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi të Komunës së Prizrenit;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për Shoqatën “Zona e Pashtrikut”;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e komisionit dhe emërimin e anëtarëve të komisionit për emërimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Prizrenit.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit nr.001/011-60689, të datës 02 korrik 2020 për mënyrën e pagesës së taksës administrative për leje ndërtimore, leje rrërimi dhe tarifa për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.001/011-68302, të datës 29.05.2025;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përgjedbjen e këshillave lokale;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për emërimin e komisionit të ankesave për procesin e zgjedhjes së këshillat lokale.

Shtesë:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për caktimin e tarifës për shërbimin e varrimit (Varrezat e reja të Prizrenit në Landovicë).

Kalojmë në pikën e parë:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së rregullt të komitetit për politikë dhe financa të datës 25 shkurt 2026.

Simir Krasniqi (Kryesues): E hapim debatin, kemi diçka me shtu për rreth procesverbalit. Atëherë që nuk kemi me shtu e hedhim në votim, konstatojmë që jemi 9, kemi kuorum mjaftë. Sa jemi për që procesverbali të miratohet? Unanimisht pra, procesverbali miratohet procesverbali i mbledhjes së rregullt të KPF-së të datës 25 shkurt 2026.

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës:

Simir Krasniqi (Kryesues): E hapin diskutimin, po.

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): Përshëndetje të gjithë. Drejtorja e shërbimeve publike e ka një pikë shtesë për rend të ditës, propozim vendimi përcaktimin e taritës dhe shërbimit të varrimit, është fjala për varrezat e reja në Landovicë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mirë, atëherë e marrim si propozim.

Haziz Hodaj (LDK): Me na shtjellu pak për çka është fjala, çka është tu u kërku, a ka ndonjë draft se se është nuk është kjo pika e rendit të ditës bash me e shti menjëherë kështu.

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): Unë e thash si titull.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po si propozim e dha, anëtarët e KPF-së pra kërkojnë sqarime më detaje se cila pikë edhe çka përmbahet në brendësi kjo pika e propozimit juaj nga ana e drejtorisë shërbimeve publike.

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): Po, komuna e Prizrenit kohë më parë ka lidhur kontratë me partneritet publiko privat me koncesionerin Pz grup nga Prizreni për ndërtimin e varrezave të reja në Landovic. Meqënëse procedurat dhe aplikimit i këtij projekti ka filluar nga viti 2016 e këndej,

të gjitha dokumentet e proceduara nga koncesioneri në fjalë, plani i biznesit, pramasa pra llogaria kanë pësuar ndryshim, si rezultat i parametrave ekonomikë dhe politikave makrofikale, domethënë që inflacioni, miratimi i pagës minimale nga ana qeverisë, kanë ndikuar që kushtet këtij operatori, domethënë çmimet në treg të shërojnë ngritje të ndjeshme. Për këtë qëllim, koncesioneri në fjalë ka bërë një kërkesë, pranë kryetarit të komunës dhe Kuvendit të komunës, që me rishiku tarifën e shërbimit të varrimit, gjithmonë është fjala për varrezat e reja në Landovicë për qytetin e Prizrenit. Për këtë qëllim, koncesioneri ka kërkuar të ndryshohet, respektivisht të rritet tarifa e shërbimit të varrimit në vlerë prej 406 euro, për një varr dhe kontributi financiar vjetor i komunes të rritet në vlerën 65.300€. Këto gjithmonë rrjedhin në bazë të dokumentave dhe kontratës që është që e ka komuna e Prizrenit. Menaxhmenti i komunës në bashkëpunim me drejtorinë e sponsorizuar, pas analizës së kërkesës të propozuar nga koncesioneri, propozon që tarifa për shërbimet e varrimit të jetë në vlerën 394 euro dhe kontributi i vjetor i komunes gjatë 65.300€. Meqenëse ky është projekt shumë i ndijshëm humanitar, është në interes të qytetarit të komunës së Prizrenit, përkrahja e këtij projekti është e domosdoshme, nëse doni ndonjë informatë shtesë?

Haziz Hodaj (LDK): Sa ka qenë përpara çmimi?

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): Përpara, kur, kur ka aplikuar, ka qenë 2015-ta, domethënë që ka konkuru me 235€, ndërsa kontributi i komunës ka qenë 49.900 diçka, domethënë rreth 50 mijë euro. Mirëpo në bazë dokumentave zyrtare të entit të statistikës së Kosovës, është marrë një norma e inflacionit kumulativ 30%, që kanë ndryshuar çmimet e materialeve, si dhe paga minimale atëherë ka qenë, mos e gaboј 250€, tash këtë vit, është 500€ ka me hy në fuqi prej prej 1 korrikut diku është propozimi domethënë që 30% është rritur për kontributin, ndërsa në përgjithësi për këtë tarifën 59%.

Dafina Alishani (LVV): Tash sa është çmimi?

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): Koncesioneri ka lyp 406, ndërsa ne si komunë kemi marrë 394

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Fejsal Hoti për prezantimin, ka dikush që do me marrë fjalën, fjala për ju Dafinë.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit shumë kryesues, kjo temë e dimë që është tepër me rëndësi, për pikën që e propozoi Fejsali. Edhe problemi kryesor në qytet është që edhe nuk ka vend nëpër varreza tash. Kështu me ngut pa pas informatë edhe pa pasur ndonjë dokument që edhe ne kolegëve mundemi me ja sqaru, nuk po e di a ka ndonjë dokument a diçka që mundeni me na dorëzue neve para se me e propozu këtë pikë, që edhe ne me grupet tona me fol edhe me pa pak a shumë edhe atë që e kemi votuar më herët. Për shkak që kur ka qenë interesimi i kompanisë ë domethënë me ja dhënë pjesën e menaxhimit të varrezave, ne e kemi pas votuar para disa muajve nëse nuk gaboј apo jo? Rregullorja po. E tash aty tarifë ka pasur nëse s'gaboј?

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): Në rregullore s'ka pas.

Dafina Alishani (LVV): E tash këtë pjesën e rritjes nuk e di a është më shumë kërkesë vetëm e pjesës së operatorit ekonomik, se tash ne mundemi me e mendu që është një ngarkesë inflacioni po inflacioni për qytetarë edhe ajo po ekziston edhe pjesa domethënë këto ndryshime a janë fol edhe me pjesën e Bashkësisë Islame, se unë nuk e di tash me këtë kompaninë e re kur të merr

menaxhimin pjesa e Bashkësisë Islame ku mbetet? Ish dashtë me pas ndoshta edhe një diskutim pak më të gjerë jo veç me KPF, po edhe akterë të tjerë të cilët janë të përfshirë në këtë proces me u bërë një takim konsultativ edhe me dalë me një propozim të përbashkët. Tash po më vjen keq se shumë njerëz janë ankuar te ne tu thënë që nuk ka vend nëpër varreza, ndërkohë ne për këto çështje administrative prap po na duhet me humb kohë. A është diskutuar hiç edhe me Bashkësinë Islame kjo ky propozim ose ky ndryshim?

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): Po kjo është normal po kjo është në ana e kontratës, domethënë që është, që është në kuadër të planit të biznesit dhe procedurave që ka aplikuar. Unë mendoj që ky projekt prej 2017 është kontrata, edhe ka pas baticat dhe zbaticat e veta ky projekti, sepse një kohë ka ndryshuar dhe çështja e pronës derisa u stabilizua edhe edhe kemi ardhur deri te ky përfundim. Unë prapë po insisto që po e them unë 2015-2016 me 2026 ndryshimet janë evidente edhe ne nëse dojmë me jetësu këtë projekt, është në interesin e përgjithshëm edhe me i rishiku këto tarifa. Bashkësia Islame ka pas kontakte edhe është pjesë edhe gjatë ndërtimit të këtij projekti. I ka kaluar të gjitha fazat ky projekt, domethënë po them kushtimisht tre qeverisje kanë ndryshuar që e kanë elaboruar dhe është felluar ky projekt, se është projekt shumë i gjatë, prej 2012 është marrë propozimi vendimi, vendimi është bërë si plan rregullativ prej 2012-s edhe ka kaluar nëpër edhe në instancat qendrore në qeverinë e Kosovës. Komitetin ndërministror për partneritet publik privat, i kanë aprovuar pesë ministra janë ata që e aprovojnë këtë projekt. I kaluar të gjitha fazat, është projekt shumë, shumë, shumë që ka qenë transparent prej nivelit qendror e deri këtu. Për dokumente shtesë, është kontrata e nderuar, është rregullorja, të gjitha këto mundemi me i shpjegu, por me një takim si kjo nuk mundemi të gjitha dokumentacionet.

Dafina Alishani (LVV): A bën veç një replikë të vogël. Unë hallin e kam kështu, mos po gabojmë diçka ne si asamble se secili qytetar ka me na përmend secilin dhurim që ne me nguti marrim ndonjë vendim, e para. E dyta, shumë herë po vijnë këtu me interes gjojase kolektiv, e në fund po na del interesi i operatorit ekonomik. Unë veç këtë hall e kam, ne tu kqyr me pa benefitin ose me ja mundësu operatorit ekonomik mos po i ngarkojmë qytetarët më shumë se sa që duhet. Qet hall e kam personalisht.

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): Unë po ta shpjegoj në aspektin profesional si ekonomist që jam. Ky projekt ka pas studim fizibiliteti, studimi i fizibilitetit i shpjegon mirë analizat financare, ekonomike, mjedisore, teknike, ligjore.

Dafina Alishani (LVV): Për 2017

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): Po po edhe kur ka aplikuar si projekt ka qenë, nuk ka qenë rentabil për koncesionerin, nuk ka qenë as për kërkënd, po si rezultat i kësaj qeveria qendrore atëhere nëpërmes departamentit partneritetit publike private ka thënë mos me dështu, duhet dhe një ndihmë shtetërore me ja bë këtij projekti, se s'është profitabil. Tash nëse dojm ne me dështu ky projekt, atëherë mundeni mos me aprovu.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Fejsal, veç pak të ndërlidhem... me këtë kjo është Dafina është urgjente se e dimë ne që varrezat e Prizrenit ndoshta dita ditës nuk do të ketë hapësirë atje për vorrime edhe materiali ju ka përcjellë gjithë parashikimet, pagat e punëtorëve të gjitha ata e keni pas material aty.... e mirë atëherë ju përcjellin atëherë ja përcjellim edhe materialin, i keni

sqarimin të gjithë me pagën minimale sa do të jetë me të gjitha edhe këtë pikë unë e shoh të arsyeshme që ta rekomandojmë në kuvend. Në kuvend do të kemi mundësi aty më gjerësisht ta diskutojmë në detaje se është si pikë urgjente shumë, urdhëro baca Haziz.

Haziz Hodaj (LDK): Dëgjo, na e dimë rëndësinë edhe urgjencën e e problemit të varrezave, po kjo urgjenca e futjes së pikës së rendit të ditës pse? 14 vjet janë në pyetje këtu dhe tash na vjen urgjent futja e pikës së rendit të ditës, për me shqyrtuar një çështje të rëndësishme. Domethënë që 14 vite... pse mos me u shpërnda materiali me kohë, me kohë me u debatu, me kohë me u shqyrtu edhe me u marrë një vendim çfarë duhet. Qekjo është problemi, se ne rëndësinë e dimë. Ne vet personalisht e kam ngrit disa herë problemin e varrezave, se 14 vite i ka, kur ka qenë Hasan Hasni drejtor i shërbimeve publike kur është prezantuar projekti i varrezave. Po tash në mënyrë urgjente me ardh ky ndryshim, un nuk e di kur e ka bë kërkesën ky operatori. Megjithatë do të duhej me... nëse jemi vonuar 14 vite, të vonohemi edhe 14 ditë se nuk bëhet kijameti. Kështu që qeky është problemi, përndryshe e futim si pikë e rendit të ditës, po duhet pak më kujdes me pas në kësi drejtime.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po fjala për ju, Arianit Berisha.

Arianit Berisha (PDK): Dafina pyeti a është e informuar në Bashkësia Islame, mua po më intereson a është e përfshirë tarifa e Bashkësisë Islame në këtë tarif.

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): Unë nuk jam pjesë e atyre negociatave që bëhen me akter të interesit, mirëpo me sa kam informacione, për ceremoninë dhe rritet fetare Bashkësia Islame ka tarif tjetër, kjo që po prezantohet që ky 394-shi, ka me u ka me u mbulu nga komuna e Prizrenit jo nga qytetarët. këtu krejt është esenca. Qytetari nuk ka me atakuar, ne krejt e kemi qëllimin veç që ky projekt me u implementu, ka pas shumë peripeci, po flas se jam kanë pjesë prej fillimit deri në fund, është projekt shumë humanitar, është projekt shumë i ndishëm edhe ka kaluar nëpër të gjitha instancat, qoftë lokale, qoftë qendrore, është felluar shumë dokumentacion.

Dafina Alishani (LVV): A për me marrë një send me lexu, a keni n dokument me na dhënë me lexu këtu bile, para se me e diskutu, sa herë që ka propozime at-hoc ju lutem një vendim me na dhënë përpara. Ajo rekomandohet në kuvend, po hallin e kam që mandej aty 41 asambleist secili ka me rekomandu diçka dhe prapë. Ideja është me pas unitet... po gabim është, unë për shembull personalisht nuk kam me dit grupin tim çka me i prezantu. Sa her vjen një pikë aty për aty ju lutem bile vendimin me na printu këtu edhe me dit na çka po diskutojmë.

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): Këtu është duke u diskutuar veç qështja e tarifës se dokumentet mundemi edhe kontratën edhe nëse duhet edhe procedurat e tenderit edhe vendimet e komitetit ministror ju sjellim gjithë dokumentacionin, sepse ata kanë kanë ndodhur më herët ato dokumentacione edhe u desht edhe më herët ndoshta bashkarisht me i shtjellu. Po këtu është duke biseduar veç një tarifë që me kontratë, me kontratë koncesioneri bashkarisht me komunën, duhet me negociju çdo ndryshim të mundshëm,

Dafina Alishani (LVV): Çmimi është 394€, totali është çka ke 60.000€ diçka,

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): Ajo është kontributi i komunës për ndërtimin e këtij projekti 65.300.

Dafina Alishani (LVV): çka ka me ndërto?

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): Nëse doni veç edhe.

Dafina Alishani (LVV): Po qysh nëse, unë po dua me ditë.

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): Unë po them që ka qenë kontrata e mëhershme, atë po them edhe është ditë, pra kontrata ka me zgjat 30 vite me partneritetin publik-privat, domethënë nëse muajin e gjashtë të vitit të kaluar është bërë tamam finale kjo kontratë. Sepse pa u sjell dokumentacioni i nevojshëm që u desh leja e ndërtimit, plani i biznesit, ndikimi mjedisit, garancioni bankar për 10% të kontratës, nuk kemi mundur. Tani ka pas probleme të tjera që ka qenë çështja e pronës derisa komuna u detyrue me ble prapë pronën prej AKP-së, 20% e kontratës e punëtorëve që i takon kemi paguar diku 570.000€ si komunë. 57 hektarshin e kësaj toke e kemi kthyer përmbi veti si komunë. Tash nëse ka filluar në 2025 ky projekt duhet me përfunduar në 2055ën, lloji i projektit është koncesion (PI, privat finance iniciativ) domethënë me kontribut me ndihmë shtetërore që ka me u dhënë çdo vit për 15 vite nga 50.000€ është kërku tash është 63.000€, investim i gjithë mbarshëm që ka me bë ky operator 2.576.287.30 euro ka me qenë në tre faza ky investim, çdo 10 vite nga 18 hektar ka me i rregullu, 18 + 18 + 18 diku bën 57 edhe çmimi që ka qenë 285€, mirëpo tash janë bërë, kur ka aplikuar se ky projekt ka filluar prej 2014s Dafinë edhe derisa është janë rregulluar dokumentacioni se u dash me marrë pëlqime prej komitetit të ministrisë.

Dafina Alishani (LVV): Sa shumë që ma përmend ministrinë mos mendo që mua më bind që gjithçka është në rregull.

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): ajo ka qenë ajo në 2014.

Dafina Alishani (LVV): Të lutna veç për hir korrektësis 65.000 euro ndërtimin e çkafit ka me bë komuna edhe për sa vjet. Mos na thoni mandej s'ka pare komuna këtu po dua me dit! Çka është kjo përgjegjësia e komunës ndaj këtij projekti 65.000€ ku shkon.

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): 2.500.000 euro ka me investu vetë koncesioneri.

Dafina Alishani (LVV): Po ato po e dimë se e kemi votuar.

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): Edhe analizat që kanë dalë ky projekt që thash, nuk është rentabil kanë i dhënë ndihmë komuna nga 50.000€, unë ndihmë shtetërore e përmenda.

Dafina Alishani (LVV): 65.000 euro a e kuptova mirë 65.000€ komuna ka me i dhënë ndihmë operatorit ekonomik, që në mënyrë me implementu këtë projekt. Kjo nuk ka qenë e planifikume më herët?

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): Në kontratë ka qenë 50.000€ ka qenë 50 mijë euro, po thashë inflacioni kumulativ që është marrë 30% për disa vite, kumulativi ose 30% edhe ka dalë kjo shumë.

Dafina Alishani (LVV): Domethënë edhe tarifa rritet edhe ndihma e komunës ndaj operatorit?

Fejsal Hoti (Zyrtar DSHP): Po!

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Fejsal, atëherë që nuk kemi diskutime të tjera e hedhim në votim rendin e ditës me propozimin nga drejtoria e shërbimeve publike që propozim vendimin

përcaktimin e tarifës për shërbimet e varrimit, varrezat e reja të Prizrenit në Landovicë. Sa jemi për që ky rendit të ditës me pikën e propozuesit nga shërbimet publike që të... të t'i rekomandohet kuvendit për mbledhjen e radhës. Unanimisht votohet dhe rekomandohet që të gjitha pikat e rendit të ditës me propozimin e përfaqësuesve nga drejtoria e shërbimeve publike pra propozim vendimin për caktimin e tarifës për shërbimet e varrimit (varrezat e reja të Prizrenit në Landovicë) t'i rekomandohet Kuvendit pra për mbledhjen e radhës. Kalojmë me pikën e tretë: shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për themelimin dhe përbërjen e këshillit komunal për siguri në bashkësi të komunës së Prizrenit. Ftojme inicuesin e pikës që ta bëjë një prezantim të shkurtë të pikës së rendit të ditës. Fjala për ju Idaim Kryeziu. Fejsal, materialet te zyrtarët këtu se duhet me ja përcjellë.

Idaim Kryeziu : Përsëritet për të gjithë. KKSBB, dmth themelimi i tij është çdo katër vite me mandat kryetarit të komunës, përbërja është sipas materialit. Propozimin domethënë e kemi, domethënë ky themelimi i këshillit për sigurinë në bashkësi në komunën e Prizrenit është me mandat katër vjeçar me mandat të kryetarit të komunës, procedurat domethënë janë kryer në korniza ligjore me afate edhe është tash kompetencë e kuvendit të komunës që ta marrë vendim për themelimin e këtij vendimi të këtij propozimi. sipas përbërjes që është edhe me udhëzim administrativ edhe është bërë ftesa publike, domethënë propozimet janë marrë, disa shkojnë në mënyrë në automatizëm, policia, fsk-ja, edhe disa institucione të tjera. disa domethënë kanë ardhur si propozime nga bashkësitë fetare, nga komunitetet dhe disa instanca të tjera, kështu që nëse keni diçka tjetër.

Simir Krasniqi (Kryesues): faleminderit, kemi diçka diskutime?

Haziz Hodaj (LDK): edhe pse kjo është skem, duhet vetëm me ja bë aminin.

Shukri Quni (BDP): Vetëm të pyes diçka. A ka qenë qeky numër gjithnjë 33 veta?

Idaim Kryeziu: Po gjithmonë u kanë, domethënë për shkak se ne si komunë kemi shumë komunitete edhe shumë bashkësi fetare, kështu që, çdo herë më shumë domethënë ka edhe rritje.

Haziz Hodaj (LDK): bashkësi fetare i kemi njejtë, tri, si krejt Kosova.

Shukri Quni (BDP): Tash te fshatrat për shembull, këshilli lokal për siguri publike një fshat...

Idaim Kryeziu: Këto janë këshillat lokale për siguri në bashkësi thirret domethënë themelohen prej policisë së Kosovës edhe Ministrisë së punëve të brendshme. Domethënë janë dy këshilla lokale për siguri, këshilli lokal domethënë është themeluar tash një për pjesën e Përdrinisë edhe e rrok edhe këtë pjesën e potgurit është Mushnikova edhe është Lubizhda, tre domethënë më fal tre këshilla lokale për siguri janë tash për tash.

Shukri Quni (BDP): A paguhen?

Idaim Kryeziu: jo fatkeqësisht domethënë me udhëzim administrativ parashihet pagesa apo ligji për buxhet nuk, e deri tash nuk ka pas.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit

Idaim Kryeziu : Se është mirë me pas në votim me votu edhe me u pagu kjo, për shkak se ka shumë instanca që japin kontributin e vet për sigurin publike në shtetin e Kosovës.

Simir Krasniqi (Kryesues): Kemi diskutues të tjerë që nuk kemi diskutues atëherë pikën e tretë shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për themelimin dhe përbërjen e këshillit komunal për siguri në bashkësi të komunës së Prizrenit e hedhim në votim. Unanimisht kjo pikë votohet dhe rekomandohet kuvendit pra për mbledhjen e radhës.

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për shoqatën zona e Pashtrikut.

Këtu gjithë jeni të informuar, është kërkesa e zonës së pashtrikut për shtatoren e Tahir Sinanit, kontributi ka qenë edhe i komunave të tjera, komunës regjionale komunës së Rahovecit, komunës së Suharekës dhe komunës së Malishevës edhe komunës së Prizrenit. Arsyeja pse nuk është kryer ndoshta kontributi sa është është cekët aty dhe në kërkesën e tyre sa është kërkuar prej komunës së Prizrenit, ju e dini që prej korrikut nuk është mbajtur seanca, jo zgjedhjet dhe të gjitha këto edhe kryetari i komunës së Prizrenit, me shumën që është caktuar do ta mbështet pra, edhe pse është përruar shtatorja e Tahir Sinanit, me shumën që materiali ju ka sjellë me kohë të gjithëve, që kemi diskutime mund të jap përgjigje, që nuk kemi ja rekomandojmë kuvendit.

Atëherë e hedhim në votim pra pikën e katërt të rendit të ditës, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për shoqatën zona e Pashtrikut? Unanimisht pra i rekomandohet kuvendit që kjo pikë e rendit të ditës t'i sjellët kuvendit.

Kalojmë në pikën e pestë, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për themelimin e komisionit dhe emërimin e anëtarëve të komisionit për emërimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në komunën e Prizrenit.

Në planin e punës, është kërku nga asambleisti Bajram Kastrati, që ju e dini që komisioni i cili ka qenë gjatë legjislaturës së kaluar, me përfundimin e mandatit, pra dhe kalon mandati i atij komisioni, disa punë këta i kanë filluar, disa ndoshta ju kanë mbetë në gjysmë për t'i kryer dhe tash legjislatura e re obligohemi që ta zgjedhim komisionin e ri pra për emërimin e rrugëve shesheve e kështu me radhë pra. E hapim diskutimin. Po Dafinë?

Dafina Alishani (LVV): Nëse se nuk gaboj që ky komision e ka pas një punë goxha të gjatë dhe voluminoz dhe në fund na informuan që është kthyer në pikën zero. Tash a jemi tu formu prapë komision të cilët ata të shkretit mbledhen e bëjnë punë të jashtëzakonshme, ku po gabojnë si kuvend, unë këtë nuk e kam të qartë. Sepse është hera e dytë që kjo punë e emërimit të rrugëve kthehet në pikën zero dhe ne vazhdimisht bëjmë komisione për emërim të rrugëve edhe vazhdimisht kemi presion edhe prej qytetarëve. Sepse ti e propozon një emër, e merr parasysht kuvendi, e voton edhe në fund nuk po kemi përgjigje pse po ku po e dështojmë. Nuk po e plotësojmë ndonjë kriter apo gabojmë dika gjatë punës së komisionit, ju kisha lut me na informu në mënyrë që me ditë çka po votojmë dhe për çka po votojmë.

Arbër Krasniqi : Ky komision është themeluar në mandatin e kaluar edhe kanë bërë një punë goxha të madhe, mirëpo nuk i kanë respektuar do procedurë që i lypte Agjensia Katastrale atje për emërimin e këtyre rrugëve shesheve, do gabime edhe teknike kanë qenë, por edhe një kërkesë u

dash me bë atje. Për këto tani u dash me anuluar vendimin që e ka marrë kuvendi. Tash Bajram Kastrati ka kërkuar që me u fut që pikë rendit të ditës, me fillu aty ku ka mbet domethënë me i rishqyrtu ato kërkesa.

Haziz Hodaj (LDK): Pasi u kthy në zero po fillon prej zeros.

Arbër Krasniqi : Po fillon prej zeros po vetëm e kanë tash ata e kanë një bazë të atij komisioni të kaluar dhe në bazë të atij vetëm me i procedu kërkesa që i kanë lyp edhe prapë me e sjellë në kuvend për miratim. Ju tash e vendosi qysh. Në plan të punës u miratu që ky komision me u formu.

Haziz Hodaj (LDK): Realisht bëhet fjalë për rrugë edhe sheshe të reja që shtohen se ato ekzistueset nuk mund të preken deri në vitin 2029, domethënë bëhet fjalë për rrugë të reja edhe edhe sheshe të reja.

Arbër Krasniqi: Listën e rezerv me plotësu qysh ka qenë edhe herën e kaluar.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po fjala për ju, Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Faleminderit, unë kam qenë anëtar në këtë komisionin, kryetar ka qenë Bajram Kastrati, po punë kemi bë, takime mbledhje kemi bë por punë me kry asi punë sështë kry. Kam qenë ndër ata që kam kundërshtu, për emrat të cilët janë propozuar, na kemi pasur një kriter edhe duhet të kemi prapë një kriter që mos të fusim ato emrat të familjarëve, babës e vëllaut e kujtdo qoftë, për pa pas një biografi që e paraqet ai komision apo, se me ligj nuk e di a përcaktohet ajo, por komisioni ka kriteret edhe aty atëherë kanë futur emrat kush ka dashtë. Edhe ajo kur e kanë parë që nuk është në rregull, nuk ka shkuar, nuk ka kaluar, edhe nëse prapë vazhdojmë në atë farë forme që ka punu ai komision, prapë nuk kalon.

Arbër Krasniqi: Vetëm e keni baci Shukri, përgjigjen e keni që dhënë ministria që me i përmirësu, vetëm bazohen në ato kritere dhe ju mundeni.

Shukri Quni (BDP): Unë nuk jam kundër asaj, se unë kam qenë në komisione për emërtimin e rrugëve edhe më herët dhe kanë qenë do kriteret të cilat janë lexuar para komisionit dhe anëtarë të komisionit kanë qenë profesorë të gjuhës shqipe, profesorë të historisë, bile edhe Besniki ka qenë, babi yt ka qenë në atë komision, ka qenë Qazim Kabashi, ka qenë Xhevat Xhoxhaj, njerëz të cilët kanë kërkuar kriterin. Kriteri ka qenë që qatij personi që unë e propozoj, unë atij duhet me ja dhënë një biografi që e meriton me pas emrin e një rruge aty, jo me fut shpiuna e udbasha të sistemit që na ka luftuar neve ose që ka qenë bashkëpunëtori i armikut tonë. Këtu ka qenë ajo edhe kemi e çu zhag këtë punë që ose të hynë njerëz të cilët kanë merita aty ose të largohen. Jo këtu nuk shkon me hatër! Për hatër tim nuk ka nevojë kërkush prej familjes time për me votu e me e pas emrin edhe me ja shkul pastaj emrin. Se ne kemi raste kur janë vendosur emrat edhe i kanë shkul me krejt atë shtyllën aty edhe ja kanë largu. Kjo është puna më e ndijshme, kushdo që propozohet këtu kjo është puna më e ndijshme. Qeky komision me të vërtetë ka punë edhe ka përgjegjësi, saqë edhe më kan thirr që pse je kundra filan emrit... për inati unë i kam thënë jam kundra filan emrit sepse udbash, ka qenë shpiun. Po a ke argumente... sa të duash kam argumente në asamble ti them argumentet. E kam thënë edhe kur e kemi pas si mbledhje, e kemi pas një komision në kuvend edhe i kam cekur. Mos të bëjmë gabime të cilat smund të fshihen pastaj. Po tham më shumë rëndë kush hyn në këtë komision se ka punë, po ne nëse punojmë si komision me kritere për të gjithë

atëherë ka me qenë puna më së miri kam me shku. Nëse futen emër aty që ka me dështu prap, se edhe ata atje në ministri i lypin biografite, ka njeri që s'ka biografi vetëm ka emrin, me lyp biografinë del katastrofë, udbash del. Kjo normal që kjo ka me u formuar se është komision që formohet, po unë e pata ku thatë që të arriturat, të arriturat janë zero zero. Hiç nuk jam i informuar a është vendosur ndonjë emër i ri i ndonjë rruge, brenda këtyre katër viteve duhet me na informu Bajramin. Bajrami është kryetar i komisionit, Bajrami e ka lyp këtë për me futur në rend dite, por Bajrami duhet me raportu për punën që e ka bërë komision. Besoj që isha i qartë.

Haziz Hodaj (LDK): E çojmë Bajramin në komision apat edhe ai mandej...

Shukri Quni (BDP): Qaty e ka ai, apat Bajrami ka me shku.

Haziz Hodaj (LDK): Ne e qojmë atë, po nëse e qojmë nëse se qojmë ai s'shkon po.

Simir Krasniqi (Kryesues): Pjesa e kuvendit duhet me e kryer punën tonë edhe unë pajtohem me lan Shukë këtu që kriteret që vet komisioni i cakton.

Haziz Hodaj (LDK): Komisioni ta formojmë njëher, mandej këto kriteret i kërkojmë në kuvend duhet. Edhe duhet me i pas parasysh secili prej prej nesh ato, jo veç anëtarët e po edhe ne që votojmë duhet me pas parasysh, me votu çdo gjë. E kemi votuar është e vërtetë, ka emra hala të rrugëve ekzistuese që janë të atilla çfarë po thua ti, fatkeqësisht.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, fjala për ju Ymrane.

Ymrane Fusha (PDK): Përshëndetje për të gjithë, unë veç kam një pyetje, ato emrat që kemi propozu ne a duhet të merren parasysh apo prej fillimit edhe njëherë duhet të propozojmë... komisioni ka pranuar të gjitha ato edhe tani.

Haziz Hodaj (LDK): Ata munden prapë mirëpo faktikisht është kthyer në zero.

Simir Krasniqi (Kryesues): komision i ri tash.

Ymrane Fusha (PDK): Komisioni i ri tash i vendos, se kanë marrë me biografi, me të gjitha që vlen njerëzit me qenë aty, faleminderit.

Dafina Alishani (LVV): A ban një kërkesë, prej juve tash si kryesues i ri. Unë qysh po e shoh ka një lëshim më shumë prej zyrës ligjore, se këshilltarët nuk kanë mund me ditë cilat janë ato procedura si komision, a mundeni bile me u zotu që keni me ndejt gati procedurave të cilat duhet një leje mos me lyp në ministri me harru. Kjo është përgjegjësia e zyrës ligjore më së pari, ju kisha lutur që mos të jetë tani kolegët tanë me u mbledhë me punu edhe në fund prap me shku në pikën zero.

Arbër Krasniqi: A mundem me dhënë përgjigje.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po Arbër.

Arbër Krasniqi : Si fillim ky komision nuk parashihet me ligj për sistem të adresave me formu. Kjo është përgjegjësi komplet e drejtorisë së urbanizmit, po kuvendet në krejt Kosovën i themelojnë këto komisionit për me i ndihmu se është punë shumë e madhe me i ndihmu komunës. Tash në përbëmje të komisionit e keni dhe një anëtar që ka me qenë prej drejtorisë së urbanizmit

dhe planifikimit hapësinor, ai anëtar ka me ja u bë komplet procedurën, obligimi i tij është me i tregu se çfarë ka me bë komisioni, i anëtarit të urbanizmit.

Shukri Quni (BDP): Drejtori duhet me qenë, drejtori i urbanizmit.

Arbër Krasniqi: Ose drejtori ose një zyrtarë prej urbanizmit. E keni edhe në pjesë të vendimit aty ku thotë që shërbimet administrative, teknike, ligjore i kryen drejtorja e urbanizmit dhe shërbimeve publike.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Arbër, kemi diskutime të tjera? Atëherë që nuk kemi, e hedhim në votim. Sa jemi për që kjo pikë t'i rekomandohet kuvendit. Unanimisht pra miratohet kjo pikë dhe i rekomandohet kuvendit, pika e shqyrtimi dhe miratimi i propozim të vendimit për themelimin e komisionit dhe emërimin e anëtarëve të komisionit për emërimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në komunën e Prizrenit.

Kalojmë në pikën e gjashtë, Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit nr.001/011-60689, të datës 02 korrik 2020 për mënyrën e pagesës së taksës administrative për leje ndërtimore, leje rrënimin dhe tarifa për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit. Ftojme inicuesin e pikës, pra drejtorin e kemi këtu që të na jepë sqarime për këtë.

Florent Ukaj: Faleminderit kryesues. E kemi një propozim vendim për shfuqizimin e vendimit, që e ceket më lartë, është një vendim që marrë në kohë pandemisë që pagesa e lejeve ndërtimore të bëhet me me këste. Ndërsa tani ne si drejtori në bashkëpunim me drejtorinë inspektoratit e kemi parë të arsyeshme që kjo nuk është më e nevojshme edhe po sjell shumë pasoja negative në dy drejtoritë tona, për shkak të punës që ato kanë si inspektorë si zyrtarët tanë dhe kemi parë të arsyeshme që duhet të hiqet kjo pagesë me rata dhe të bëhet vetëm siç ka qenë në vendimin e mëhershëm. Duke e ditë që është marrë për kohë në kohë pandemie me dalë në ndihmë të bizneseve e qytetarëve.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor, a kemi diskutime rreth kësaj pike?

Ymrane Fusha (PDK): Vetëm një pyetje kam.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po urdhëroni.

Ymrane Fusha (PDK): Drejtor a ka rritje të çmimit të rrënimin apo tarifa apo do të jetë ajo tarifa.

Florent Ukaj: Jo tarifa është e njëjtë, vetëm ndryshohet mënyra e pagesës, kemi pas raste kur u pagu për shembull rata e parë dhe rata të tjera nuk janë paguar.

Arianit Berisha (PDK): Një pyetje për drejtorin.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po urdhëro.

Arianit Berisha (PDK): Këto pengesa që i përmende, veç pak me na i sqaru se ka pyetje të shumta që sidomos ne që jemi asambleist për herë të parë, nuk po dimë nganjëherë me dhënë përgjigjen e duhur, sidomos edhe vendimin paraprak nuk e kemi të bashkangjitur, që kisha kërkuar me e pas, deri të hënën, çfarë natyre janë ato pengesa që po hasni ju dhe inspektorati.

Florent Ukaj: Për shembull njëra prej pengesave, e thashë është që paguhet vetëm rata e parë për me marrë lejen dhe nuk ka më. E ndërton për shembull e kemi me etazhitete ose me objekte. E ndërton, inspektoriatu po janë për shembull tu dit kapacitetet pak inspektorë të ndërtimit, ndërtime ka shumë edhe nuk po mundën në kohë me e përcjellë ndërtimin. Dhe kur po shkojnë aty kur po e shohin që u ndërto tre kate, nëse u leju për një kat për shembull pagesa e parë me bë, kur po shkojmë në vend ngjarje ndërtimi ka ndodhur tre ose katër katë edhe nuk po kemi ndonjë ndonjë mënyrë që me. Kemi raste kur veç u pagu rata e para dhe asnjë ratë tjetër... ndërtimi është kryer dhe më ne.

Dafina Alishani (LVV): Më fal a nuk është për secilën pllak kur ta qet me e leju inspektoriatin edhe inspektoriatu me pas kontroll a? Me rregull qashtu është.

Florent Ukaj: Po ne për shembull në vendimin që me etazhitete me asi ja propozon.. vendimin e merr edhe inspektoriatit po duke e ditë që vëllimi i madh i punëve që është në Prizren, nuk po mundën në kohë me dalë në vend ngjarje.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor për sqarime, fjala për ju, Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Drejtorë, je risht në këtë punë, të kam uru për punën që e ke marrë, e ke një drejtori më të ndejshme, qajo që the më nxiti se kur po shkojmë po e shohim tre katër kat tu u maru, kjo si drejtor nuk është në rregull. E thashë je në fillim....

Florent Ukaj: po ka raste ne nuk shkojmë la Shukë, po shkojnë inspektorati....

Shukri Quni (BDP): Unë e di që nuk shko ti, po ty të informoj. Unë po ta tregoj një rast kur është ndërto një objekt nuk e tham... ka qenë me u ndërto 5,6 katë edhe e kanë informu kryetarin Ramadan Muja ka qenë kryetar. Në atë moshë është ngjit shkallve përpjetë, ka shku i ka kqyr a është e vërtet a jo. Prizrenin edhe në asamble e kam thënë, e keni bë një katund të keq, jo në qytet, po marr shembull sa herë kam edhe në asamble se këtu tani veç ra biseda, rruga e Nashecit 5 metra e gjysem, 6 u bë. Ndërtimet që janë bë, nuk ka mundësi me kalu' aty tërë ata njerëz që kanë me banu. S'di qysh po e blejnë ata atë banesë kur s'ka rrugë aty, te ne të gjithë kemi kqyr për me marrë një pllac, a një shtëpi, a ka rrugë njëherë si pik e parë. Ajo rrugë është shtru kur ka qenë në pushtet Haziz Hodaj, unë nuk e kam kqyr kush është në pushtet, une kam kqyr me u shtru rruga. Rruga nuk është e gjerë për tërë ato ndërtime, ajo rrugë e thash që e kemi bërë me participim në 2005ën 2004 kur ka qenë pushtet Eqrem Kryeziu. U planifiku për një rrugë regjionale, Nasheci me kanë aty, Atmaxha kanë daljen ka Landovica, Grazhdaniki 40 50 shtëpi janë, Kobaj shkojnë nga Vlashja, rruga u bë për Nashec edhe do fshatra të Hasit. Ato ndërtime, ajo rrugë s'mund i bartë, po habitna qysh po blejnë njerëzit aty banesa, kur s'ka rrugë ka me kalu! Edhe në asamble e kam thënë është bë katun i keq, kanalizim s'ka drejtor, drejtor në atë rrugë qitet kanalizimi në asfalt po çudita mediat nuk shkojnë sa herë e ngres këtë çështje, e merr gypin përmbi mur edhe e derdhë grupën e flliqtisë e qet në rrugë. S'po di a keni mundësi ju për shembull kur e tejkalon edhe me shku me ja prish? A shkojnë ata, a dalin me kqyr? E pse mora shembull kryetarin Ramadan Muja, në atë moshë ka hyp përpjet shkallëve me shku me kqyr a përnime e kanë çu dy kat më tepër a një kat! Te unë ka ardhur shumë herë kur kam bë kërkesa në asamble.. Ramadan Muja. Me e kqyr a është vërtetë apo jo, se i thoshin ata jo more se është duke bë kërkesë që nuk ka nevojë popullat. Vinte këqyrke a është me të vërtetë që ajo me u investu apo jo. Kush i kontrollon tash këto? A ka mundësi

me ditë për shembull çfarë interesi është i qytetarëve me shku me ndërto me një rrugë 5 metra gjerësi ato ndërtimet ka 15 kat a 10 kat a sa janë. Ose unë e di që disave ndoshta ju duket Prizreni është duke u bërë një punë që dikur më vonë ka me na dhënë vërejtje neve.. sikur unë që po e livdoj tash kryetarin e juaj ish kryetarin e juaj Eqrem Kryeziun edhe neve dikush ka me na ma livdu në të ardhmen. E kreu kryesues!

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju drejtor.

Florent Ukaj: La Shuk, pajtohem plotësisht me atë që the. Mirëpo kur kam shku në atë drejtori edhe i kam pa problemet që janë në vazhdimësi, e kam bërë veten edhe fajtor, pse fajtor sepse na si asamble edhe unë kam qenë asamblist edhe ti La Shuk, e kemi votuar një hartë zonale domethënë procesin kryesor për... për pse ndodhin ato ndërtime pikërisht për atë, jam unë edhe ti se jemi kanë të dytë asambleistë bashkë me këta kolegë të tjerët. Tash aty unë e kam parë që harta zonale ka probleme të theksme dhe pajtohem plotësisht me ato që do thu që sidomos rruga e Nashecit rruga e Arpri-jës që po ngarkohet, është pasojë e Hartës zonale domethënë nuk është vetëm e drejtorisë së urbanizmit. Tjetra tha për kanalizimet, ne te kushtet e qesim drejtorja e urbanizmit që duhet me kërkim investitori duhet me kërkim një pëlqim prej hidroregjonit prej kedsit janë disa kushte që duhet plotësuar dhe na pa ato kushte nuk mundemi me dhënë leje. Pa ato pa pëlqimet që i kërkojmë aty nuk e japim asnjë leje, së paku sa jam unë aty e kam parë që pa ato pëlqime unë nuk e nënshkruaj. Hidroregjioni e jep pëlqimin që mundet me pas kanalizim, mundet me pas suv, edhe aty është e gjitha. Ama fajtor, kemi një pjesë të përgjegjësis, unë edhe ti. Harta zonale ka shumë, shumë probleme.

Haziz Hodaj (LDK): Nuk është veç harta zonale, harta zonale është katër pesë vjetëshin e fundit edhe janë bë...

Florent Ukaj: Unë po e shoh që Harta zonale, që është po më vjen keq prej vetes pse tash po e shoh që pse e kam votuar kur, aty janë ndërtime harta zonale e ka paraparë rrugë me u bërë me një pjesë të caktuar për shembull kur ndërtimi ose një parcelle e njëjtë gjysma është tokë bujqësore gjysma ëtokë ndërtimore i kam par tash do probleme të theksuara që janë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor për sqarime.

Florent Ukaj: Unë mendoj që edhe rregullojmë pak tregun e investimeve, nëse një investitor e parasheh me një investim 10 milion euro dhe nuk është i gatshëm me i paguar 100 mijë euro në ose 150.000 ose 200.000 sadok në fillim të lejes, besoj që nuk është serioze.. le ta paguajmë njëherë taksën tamam komplet, ama me këtë vendim ne e kemi mundësuar atyre që me i pas këto këto privilegje.

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë e hedhim në votim pra pikën e gjashtë që t'i rekomandojmë kuvendit. Sa jemi për? Unanimisht pra i rekomandohet kuvendit pika e gjashtë shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit numër 001/001/60689 të datës 2 korrik 2020 për mënyrën e pagesës së taksës administrative për leje ndërtimore leje rrënimi dhe tarifa për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit.

Kalojmë në pikën e shtatë: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.001/011-68302, të datës 29.05.2025. Drejtori i punës dhe mirëqenies sociale është këtu inicuesi i pikës fjala për ju drejtor.

Fatmir Memaj: Po faleminderit kryesues i përshëndes anëtarët e kuvendit komunal dhe të pranishmit të tjerë. Besoj shumica e të pranishmëve janë në dijeni për miratimin e një vendimi në vitin e kaluar, vendimi ka të bëjë me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim organizatave të shoqërisë civile, me të cilin edhe këto organizata kanë me dhënë shërbime psikosociale për këtë kategori, bashkë me këtë vendim për dhënien në shfrytëzim është formuar edhe komisioni i atëhershëm vlerësues që ka me zhvilluar procedurat e vlerësimit, kur del më vonë në shpalljen publike. Ky objekt domethënë për vlerësimin domethënë vendimi i parë është miratuar ligjshmëria për dhëni në shfrytëzim si akt është miratuar nga ana e ministrisë edhe vendimi i dytë është miratuar është bërë konfirmi i ligjshmërisë për këtë komision, mirëpo me një pikë që thotë pezullohet zbatimi i vendimit, fjala është për këtë vendimin e këtij komisioni, zbatimi i vendimit, për formimin e komisionit vlerësues edhe në arsyetimin e ka sqaruar ministria sepse asamblatë kur janë në fazën e fundit, gjashtë mujorin e fundit para mbajtjes së zgjedhjeve vijuese lokale, atëherë nuk ka të drejt me zhvillu procedurat mëtutjeshme për këtë qëllim. Kështu që ne kemi konsultuar ministrinë sepse kemi pasur një dilemë të vogël lidhur me... për shkak se përbërja e komisionit të kaluar, domethënë realisht përveç Ilir Gashit asnjë anëtar nuk është aktiv këtu dhe as në ekzekutiv as në asamble. Nëse më lejoni me lexu përbërjen e kaluar ka qenë në këtë komision Egzona Hoxhaj anëtar nga Kuvendi, Ilir Gashi anëtar nga Kuvendi, Ramize Sinanaj anëtare nga ekzekutivi, Shpresa Murati anëtare nga ekzekutivi dhe Latif Hoxhaj, anëtar nga sektori joqeveritar. Sikur që e parashih që këto komisione për secilën dhënie është komisioni i posaçëm. Besoj s'kam nevojë, edhe formulën se qysh me i zgjedh, domethënë dy nga Kuvendi i komunës, dy nga ekzekutivi edhe një nga sektori joqeveritar. Prandaj ne, për shkak të kësaj përbërje kemi pas dilema a duhet me bë vendim të ri apo me si si me e bë vendimin që e kemi parashtruar sot edhe nga ana e ministrisë është thënë se duhet propozim për plotësimin, ndryshimin e këtij vendimi me numër kaq sikur se ka qenë i miratuar atëherë. Sepse konfirmi i ligjshmërisë veç ekziston për këtë vendim edhe pezullimi unë bërë për këtë arsye që u cek, domethënë pezullimi i komisionit i vazhdimit të punës së komisionit tash është nevoja me domethënë me plotësu me ndryshu.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit të drejtor për sqarime.

Haziz Hodaj (LDK): Domethënë vendimi metet i njëjtë veç çështja.

Fatmir Memaj: Qëllimi mbetet i njëjtë, vetëm, domethënë anëtarët ndërrohen për shkak, plotësohen ndryshohen, për shkak se nuk janë më ata anëtarë.

Dafina Alishani (LVV): A propozohen emrat në seancën e radhës?

Simir Krasniqi (Kryesues): Po atëherë që nuk kemi diskutus për këtë pikë, e hedhim në votim që t'i rekomandohet kuvendit.

Haziz Hodaj (LDK): Paraprakisht do të duhet me e ditë një skemë kush propozon ?

Dafina Alishani (LVV): Dihet!

Simir Krasniqi (Kryesues): Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.001/011-68302, të datës 29.05.2025, votohet dhe i rekomandohet kuvendit pra për mbledhjen e radhës.

Kalojmë në pikën e tetë: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave lokale. E kemi drejtorin e administratës këtu, inicuesin e pikës, mund të na jep sqarime, fjala për ju.

Bexhat Bytyqi : Faleminderit, përshëndetje për të gjithë. Edhe vitin e kaluar ka qenë ky komision, po me përfundimin e mandatit edhe ky komisioni bjen domethënë prej prej funksionit, kështu që... e kemi parë të arsyeshmen që duhet me formuar komisionin e ri, për arsye se kryetarët e bashkësive lokale janë zgjedhur pothuajse të gjithë, po njëri prej tyre ka dhënë dorheqje e kështu që gjatë këtij mandati mundet edhe dikush ose del në pension ose nuk do me u marrë me këtë aktivitet dhe për këtë arsye kemi parë shumë të rëndësishme që ky komision me ekzistë, që në raste kur ka nevojë me zgjedh dhe kryetarë të bashkësive lokale me qenë komisioni i gatshëm. Sipas rregullores janë 7 anëtarë, 4 nga kuvendi, 1 nga ekzekutivi, 1 nga shoqëria civile dhe 1 përfaqësues i fshatit.

Arbër Krasniqi: Komisioni ka qenë i ndarë nga të gjitha subjektet politike, ata që skanë pas mundësi me hy në këtë komision, kanë pas përfaqësim në komision të ankesave.

Shukri Quni (BDP): Në koalicion... Karanfili ka qenë me 13 sa i keni pasë....

Dafina Alishani (LVV): Atëherë ka qenë, kryesuesja ka qenë bashkëpunuese dhe shumë demokratike... secilin komision e ka pas pozitë opozitë, po ky kryesuesi i ri tash s'po mundet.

Simir Krasniqi (Kryesues): s'po na lejon ligji.

Dafina Alishani (LVV): Për hirë të demokracisë, mundesh me bë laromaninë e grupeve të partive politike, secilin komision për monitorim më të mirë, po nuk po doni edhe kështu që vazhdoni.

Simir Krasniqi (Kryesues): Në këtë komision e kemi planifiku, që do të hyjnë të gjithë.

Haziz Hodaj (LDK): Qeky komision do duhej me u marrë edhe me zgjedhje se atyre ju kalon mandati këtyre kryetarëve.

Bexhat Bytyqi: 2028 kanë mandat.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju, Shukri.

Shukri Quni (BDP): Drejtor, unë e kam kundërshtuar këtë përzgjedhjen e këtyre kryetarëve të bashkësive lokale dhe se kam votu edhe pse kemi qenë në koalicion me ju, sepse nuk është bërë një punë e mirë në disa fshatra, për shembull kam kundërshtuar, në Mazrek, Planëj, Gorozhup, pesë katune e ka një kryetar. Unë e kam kundërshtuar, pse nuk i zgjedhim ne kryetarët e secilit fshat. Njerëzit kush i kryen këto punë, i kryen për shkak të vullnetit të mirë që e ka, "ose edhe ajo që ka qejf me i hy pushtetit në hatër. Kështu që më mirë si kuvendi bë me i pas zgjedh krejt kryetarë, për shembull ka shumë bashkësi lokale me një kryetar, ata se njohin kryetarin e bashkësisë lokale. Ti zgjedhim më mirë kryetarët e secilit fshat, shumë më mirë është.

Haziz Hodaj (LDK): Po nuk është lejuar për shkak të skemave që janë paraparë në nivel qëndror është udhëzimi administrativ. E dijmë që nuk ka me funksionu, sepse nuk e njeh për kryetar të një fshati tjetër edhe pike. Për çështje praktike ne do të duhej me bë, pa marr parasysh a paguhen a jo, ne do të duhej me i zgjedh jashtë asaj urdhërese administrative, si organizim i brendshem, le të funksionoj, më mirë diqysh sa hiq!

Simir Krasniqi (Kryesues): Edhe këtu sa e di unë që numri është kufizuar te disa fshatra më të vegjël për shkak të numrit.

Haziz Hodaj (LDK): Ky edhe drejtor edhe nënkryetar e bën!

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë hedhim në votim pikën e tetë. Unanimisht pra votohet miratimi i propozim i vendimit për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave lokale dhe i rekomandohet kuvendit pra për mbledhjen e radhës.

Kalojmë në pikën e nëntë, edhe kjo pikë pra lidhet me pikën e tetë, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për emërimin e komisionit të ankesave, për procesin e zgjedhjes së këshillave lokale. Drejtor, këtu na duhet dy vendime edhe të ankesave.

Bexhat Bytyqi: Edhe këtu ka me u zgjedh një komision për ankesat që kanë, ka me i shqyrtu ankesat, prej tre anëtarëve përbëhet.

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë e hedhim në votim në pikën e nëntë. Unanimisht edhe kjo pikë i rekomandohet kuvendit, pra pika e nëntë shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për emërimin e komisionit të ankesave për procesin e zgjedhjes së këshillave lokale.

Kalojmë në pikën e 10 pra që kjo pikë u iniciua sot nga drejtorja e shërbimeve publike, propozim vendim përcaktimin e tarifës për shërbimet e varrimit, varrezat e reja në Prizren në Landovicë.

Në fillim pra nga propozuesit morën sqarime, po këtu do ta furnizon me materialin shtesë të gjithë kuvendarit pra pas përfundimit të seancës edhe keni mundësi pra me diskutu atë ditë në kuvend. Atëherë e hedhim në votim pikën e dhjetë. Unanimisht edhe kjo pikë votohet pra propozim vendimi përcaktimin e tarifës për shërbimin e varrimit, varrezat e reja të Prizrenit në Landovicë që t'i rekomandohet kuvendit.

Ju faleminderit për pjesëmarrje, e mbyllim këtu, faleminderit dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në ora: 11:15

